

Arrestime dhe konfiskime armësh në Graqanicë, Prishtinë dhe Barilevë



17/08/2025 10:43

f

t

l

Njësitë policore kanë ndërmarrë një sërë veprimesh gjatë 16 gushtit lidhur me armëmbajtje pa leje në zona të ndryshme të Kosovës, duke rezultuar me konfiskime armësh dhe arrestime.

Në fshatin Gushterica e Epërme, Graqanicë, rreth orës 08:30, është gjetur dhe konfiskuar një pushkë gjuetie në posedim të një mashkulli kosovar. Sipas raportit policor, i dyshuari nuk ka bashkëpunuar me autoritetet dhe dyshohet se ka probleme psikike, ndaj është dërguar për trajtim në repartin psikiatrik në Mitrovicë.

Më vonë rreth orës 21:45, në rrugën B në Prishtinë në një pikë kontrolli, është ndaluar një veturë me targa vendore, ku drejtuesi i saj, një mashkull kosovar ka pranuar se posedon armë. Policia ka konfiskuar armën, e cila ka rezultuar pa municion. I dyshuari është intervistuar dhe rasti ka kaluar në procedurë të rregullt sipas vendimit të prokurorit.

Në fshatin Barilevë, rreth orës 22:35, është arrestuar një mashkull kosovar pasi dyshohet se ka shtëinë me armë zjarri. Në vendngjarje janë sekuestruar një pistoletë me gaz dhe 16 gëzhoja. Pas intervistimit, me vendim të prokurorit, i dyshuari është liruar në procedurë të rregullt.

LAJME TË FUNDIT

- 

87 vatra zjarri të regjistruara në Kosovë, 8 prej tyre ende aktive
- 

Mot i ndryshueshëm javën e ardhshme, reshje shiu e diell
- 

Vuçiq ua lëshon një kërcënim studentëve: S'do të...
- 

Metaj: Zjarrvëniet e qëllimshme po e rëndojnë situatën

Artikuj të ngjashëm



August 17, 2025

87 vatra zjarri të regjistruara në Kosovë, 8 prej tyre ende aktive



August 17, 2025

Mot i ndryshueshëm javën e ardhshme, reshje shiu e diell



info@lajmi.net
Tel: +383 49 131 131
B.r. Zenel Salihu nr. 28, zyrya nr.

RRJETET SOCIALE



Other Links

- Fact-Checking Policy

Ethics Policy

Corrections Policy

Ownership & Funding Information

Editorial Team Information